



Perspektiva juaj
është sfida jonë!

Fondi më i ri në fushën e investimeve

Raport Muaji Nentor 2021

Informacion bazë

Administrimi i Fondit	Raiffeisen Invest sh.a
Monedha	LEK
Datë Lancimi	20 Gusht 2018
Datë e mbarimit te Ofertes	03 Shtator 2018
Fillestare	
Vlera fillestare e kuotës	1,000
Shuma fillestare minimale	30,000
Shuma minimale pasuese	10,000

Komisione dhe Tarifa

Tarifë në hyrje	0%
Tarifë në dalje	2% (cdo shlyerje para 2 viteve)
Tarifë Administrimi në vit	Deri ne 1.15% e vleres neto te aseteve

Tarifa te tjera te vazhdueshme **Referojuni prospektit te fondit**

Komisione/tarifa të vazhdueshme **1.25% per vitin 2020**

Kosto për transfertë fondesh nga palë të treta **Referojuni informacionit ne degët e RBAL**

Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Objektivi i Fondit është të maksimizojë kthimin total afatmesëm, duke synuar të ruajë kapitalin e investitorit dhe të sigurojë likuiditet të mjaftueshëm.

Fondi synon të ketë një portofol investimesh të përqëndruar kryesisht në instrumente borxhi të emetuara ose garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.


Për të maksimizuar kthimin total nga investimi, Fondi synon investime afatgjata dhe për këtë arsye, fondi investon të paktën 50 – 80% të aseteve ne obligacione afatgjatë te Qeverisë shqiptare.

Shifra e tarifave të vazhdueshme 1.25% mbështetet në shpenzimet për vitin e mbyllur më 31.12.2020. Kjo shifër mund të ndryshojë nga viti në vit. Tarifa totale e vazhdueshme nuk mund te kalojë maksimumin prej 1.4% ne vit te vlerës neto të aseteve te fondit.

Kostot e transaksioneve janë sipas kushteve të punës të palëvendërmjetësuese dhe nuk përfshihen në llogaritjen e komisioneve dhe tarifave të vazhdueshme, por ato i ngarkohen Fondit.

Profili i Rrezikut dhe Përfitimit

Rrezik i ulët Rrezik i lartë
Përfitimet tipike më të ulëta Përfitimet tipike më të larta



Profili i parashikuar i Rrezikut dhe Përfitimit të fondit Raiffeisen Vizion i përket kategorisë së tretë.

Ky nivel i treguesit është rezultat i aplikimit të politikës së investimit të fondit me të dhënat historike të normave të interesit për 5 vitet e fundit.


Treguesi i rrezikut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel rreziku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa rrezik. Ky tregues ka për qëllim tju informojë mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e rrezikut në të ardhmen.

Të dhëna për Fondin në 30.11.2021

Vlera Neto e Aseteve	17,111,990,503
Numri i investitoreve	6,034
Cmimi i Kuotes	1,121.3571
*Kthimi nga investimi (30.11.2020 - 30.11.2021)	4.24%

*Komisioni i administrimit zbritet përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

Struktura e portofolit të investimeve në 30 Nentor 2021



Ne kuader të politikës së investimit të fondit Vizion, investimet kryhen kryesisht në obligacione thesari, të emetuara ose garantuara nga Qeveria shqiptare, përmes pjesëmarrjes në ankandet e tregut primar dhe transaksioneve në tregun sekondar.

Politika e investimit parashikon që të paktën 50 – 80 % e asetëve të fondit të investohen në obligacione afatgjate të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Bonot e thesarit 12 mujore emetohen dy here në muaj; Obligacionet 2 vjeçare një here në muaj; 7 dhe 10 vjeçare janë me të rralla, afërsisht një here në tre muaj. Qeveria organizon ankande të obligacioneve referencë 5 dhe 3-vjeçare me frekuencë një here në 2 muaj për secilin maturitet.

Instrumenti	Në % të Aseteve të Fondit
Bono Thesari	3.04%
Obligacione Thesari	82.73%
Depozita / Llogari rrjedhese/ Te arketueshme	11.40%
Marreveshje të Anasjellta të Riblerjes – Rev Repo	2.83%

Vlera neto e asetëve të fondit është në nivelin e LEK 17.11 miliardë në datë 30 Nentor 2021.

Zhvillimet dhe ecuria e normave te interesit te titujve te Qeverise Shqiptare gjate muajit Nentor

Gjate Nentorit, moti më i ftohtë ka shkaktuar një rritje të madhe të shkallës së infektimit në Europë. Nga ana tjetër, duke qene se vaksinimi në SHBA është në përgjithësi në nivele më të ulëta, ekziston rreziku i një rritjeje sezonale të numrit të infektimit edhe në SHBA. Austria filloi karantinën totale në mes të muajit, gjithashtu Gjermania apo edhe vende të tjera, mund të ndjekin të njëjten rrugë për shkak të rritjes së infektimit dhe rasteve në terapi intensive. Varianti i ri i virusit Omicron i shfaqur në Afrikën e Jugut dhe i përhapur në shumë shtete ka shtuar rreziqet për rritjen e infektimit.


Situata shëndetësore në Shqipëri është përmirësuar gjatë muajit Nentor dhe përhapja e virusit është qetësuar, ndërsa procesi i vaksinimit vijon të kryhet.

Asetet e Fondit Vizion janë të investuara vetëm në bono dhe obligacione të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe për këtë arsye fondi është i ekspozuar ndaj ndryshimeve në normat e interesit të këtyre titujve. Kështu investimet e fondit nuk kanë lidhje direkte me tregjet ndërkombëtare, por impaktohen kryesisht nga zhvillimet në tregun e brendshëm siç janë ndryshimet në normat e interesit të titujve të Qeverisë Shqiptare.

Përgjatë muajit Nentor në tregun vendas normat e interesit të titujve të emetuar nga Qeveria Shqiptare patën një trend përgjithësisht rënës, përveç yield-it të Bonos së Thesarit 12-mujore i cili rezultoi në 1.713% duke u rritur lehtë me 0.02% në krahasim me ankandin e muajit Tetor. Ndërsa Yield-i i Bonove 3 dhe 6 mujore rezultoi përkatësisht në 0.819% dhe 1.311% duke rënë përkatësisht me 0.18% dhe 0.03% në krahasim me ankandet e fundit.

Për sa i përket obligacioneve, ankandi i rihapur i obligacionit 2 vjeçar-i i emetuar në LEK rezultoi në 2.10%, duke rënë me 0.10% në krahasim me normën e ankandit paraardhës. Gjithashtu u zhvillua edhe ankandi i obligacionit referencë 5-vjeçar i cili rezultoi në 3.467%, duke u rritur lehtë me 0.014% krahasuar me ankandin e fundit të muajit Shtator. Për herë të parë Qeveria Shqiptare emetoi obligacion thesari me afat 15 vjet, afati më i gjatë i emetura deri tani dhe yield-i rezultoi 5.88%.

Grafiku më poshtë jep një pasqyrë të ecurisë së normave të interesit të bonove dhe obligacioneve të thesarit të emetuar nga Qeveria Shqiptare gjatë periudhës 1-vjeçare Nentor 2020 – Nentor 2021. Për obligacionet referencë 3 dhe 5 vjeçare janë paraqitur yields fikse të perlojaritura nga kuotimet e kontributoreve në fund të muajit Nentor.




Performanca e fondit dhe ecuria e çmimit të kuotës deri në 30 Nentor 2021

Fondi Vizion ka patur një performancë pozitive, çmimi i kuotës është rritur me **+0.20%** gjatë muajit Nentor.

Ndërsa kthimi me baze vjetore, për periudhën 30 Nentor 2020 – 30 Nentor 2021 është 4.24%.

Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon në varesi të kushteve të tregut, siç janë ndryshimet e normave të interesit të titujve të borxhit të emetuar nga Qeveria Shqiptare. Kështu kur normat e interesit në treg rriten, vlera e titujve të portofolit ulët dhe për rrjedhojë ulët dhe norma e kthimit për periudhën e kaluar. E kundërta ndodh kur normat e interesit ulen.

Per pasoje, çmimi i kuotes mund te jete i luhatshem. Luhatshmeria eshte pjese e natyrshme e fondeve te investimit dhe eliminimi i saj eshte i pamundur, keshtu çmimi i kuotes mund edhe te bjere, jo vetem te rritet.



Fondi Vizion aplikon nje periudhe minimale qendrimi ne fond prej 2 vitesh. Cdo shlyerje perpara permbushjes se periudhes 2-vjet, do te jetë subjekt i nje tarife dalese prej 2% e vleres se kuotave te shlyera.

Pertej minimumit kohor te qendrimin ne fond, Investitoret e fondit Vizion dhe te gjithë fondeve te administruara nga Raiffeisen Invest keshillohen te kene nje horizont sa me te gjate investimi per te perfituar nje kthim optimal nga investimi dhe ne kete menyre ne periudhe afatmesme apo afatgjate te kene mundesi te rikuperojne edhe efektet negative te krijuara afatshkurter.

Per fondin Vizion ky horizont i rekomanduar i qendrimin ne fond eshte te paktën 3 vjet, duke patur parasysh natyrën afatgjatë të investimeve të parashikuara në strategjinë e investimit të fondit dhe ne menyre qe te permbushet objektivi i performancës së fondit. Investitoret inkurajohen qe te ruajne investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qendrimin ne fond te nxitur nga situata jo e zakonshme e krijuar nga pandemia globale, sepse ne kete menyre nuk do te rrezikojne te dalin nga fondi ne momentin e gabuar per investimin e tyre.

Të dhënat per kthimin nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë nje premtim apo garanci per kthimin ne te ardhmen. Te gjithë shembujt e tjere numerike, jane perdorur per qellime ilustrative dhe analize te te dhenave historike, dhe nuk duhen perdorur nga investitoret per te nxjerre konkluzione per te ardhmen.

Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojnë nje kthim te caktuar te fondit. Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen Invest sha., në web site www.raiffeisen-invest.al ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.